



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 765/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada - Gillogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Fatbardha Emini,- Halabaku kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.765/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar Fatbardha Emini,- Halabaku, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimin 2601x/04D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.765/2021 nga Fatbardha Emini,- Halabaku, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në vendvotimin nr.2601x/04D, dhe kërkon rinumërimin sa i përket këtij vendvotimi. Apelit si provë i ka bashkangjitur një formular dhe një deklaratë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Fatbardha Emini,- Halabaku, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkon rinumërim të votave në vendvotimin nr.2601x/04D.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.765/2021, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Fatbardha Emini,- Halabaku, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, më të cilin apel kërkon rinumërim të votave për kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës për vendvotimin nr.2601x/04D është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret. Paneli, nuk mundi të konstatoj nga Formulari i rezultateve të Kandidatit numri i vendvotimit të cekur se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, sepse edhe kandidatët e radhitur me numrat të afërt me te nuk kanë pas vota çka nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Fatbardha Emini,- Halabaku, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr. 765/2021 më datën 06.03.2021**

**Kryesuesja e Panelit**  
**Kymete Kicaj**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

